

Pse të investoni tani në burime të ripërtërishme të energjisë?

1. Shpenzimet të vogla:

Çmime shumë më të lira sesa disa vite më parë.



2. Skema të ndryshme të mbështetjes:

Shfrytëzoni skemat e mbështetjes të institucioneve qendrore dhe donatorëve ndërkombëtar për investime në teknologji eficiente dhe të gjelbërta.



3. Jetëgjatësi e produkteve të burimeve të ripërtrishme të energjisë.

Produktet kryesore të prodhimit të energjisë së ripërtrishme kanë jetëgjatësi shumë më të lartë sesa vite më parë dhe janë shumë më efikase.


Investoni në burimet e ripërtërishme të energjisë

1. Panelet diellore fotovoltaike:

Shfrytëzoni energjinë e pastër nga dielli për të mbuluar konsumin tuaj të energjisë.

2. Sistemet diellore për ngrohjen e ujit sanitar.

Redukton deri në 60% konsumin e energjisë për ngrohjen e ujit.



Hapat që mund të ndiqni sot:

1. Analiza e konsumit të energjisë:

Identifikoni pajisjet me konsum të lartë, përdorni matës inteligjentë dhe optimizoni oraret e përdorimit për kursime maksimale.

2. Zgjidhni izolimin dhe ndriçimin e duhur:

Një investim i vogël sot, kursime të mëdha në të ardhmen.

3. Konsideroni burimet e ripërtërishme të energjisë:

Panelet diellore apo sistemet diellore për ngrohjen e ujit sanitar mund të ulin ndjeshëm shpenzimet.



E ardhmja është e gjelbërt, bashkohu edhe ti!

Zgjidhjet për Eficiencë të Energjisë:


1. Termo izolimi i jashtëm dhe i brendshëm:

Kurseni deri në 30% energji me termo izolim cilësor të mureve, dysHEMEVE dhe tavanit.




2. Dritaret eficiente:

Dritaret eficiente ndihmojnë të mbani nxehtësinë brenda gjatë dimrit dhe freskinë gjatë verës.



3. Ndiriçim LED:

Konsumi deri në 80% më i ulët krahasuar me ndiriçimin tradicional jo efikas.



4. Pajisje me klasë energjetike të lartë:

Pajisjet moderne konsumojnë më pak energji dhe zgjasin më shumë.



**ENERGJIA
E PASTËR
ËSHTË
E ARDHMJA**

Kurseni energjinë, mbroni planetin!

Përse të zgjedhim eficiencën e energjisë?

1. Kursime të konsiderueshme financiare:

Më pak shpenzime në faturat mujore të energjisë.



2. Komoditet më i lartë:

Termo izolim dhe teknologji eficientë për ngrohje dhe ndiriçim optimal.



3. Mbrojtje e mjedisit:

Ulja e konsumit të energjisë nga burimet fosile ul emetimet e gazrave serë, duke ndikuar në mbrojtjen e mjedisit.

*Ta ruajmë
planetin*



4. Rritja e vlerës së pronës:

Instalimi i sistemeve diellore dhe izolimi i mire i shtëpisë/banesës suaj rrit kualitetin dhe vlerën e pronës tuaj.



Kurse energjinë, ruaje planetin / Eficiencia fillon nga ti – kurse energjinë, ruaje planetin / Eficiencia fillon nga ti